



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.841/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Edona Ajeti nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Edona Ajeti, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me shenjën ZL.Anr.841/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Edona Ajeti, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me të cilën ka pretenduar se në fshatin Strezoc, komuna e Kamenicës emri i vëllaut të saj nuk ka figuruar në asnjë listë të vendvotimit edhe pse është banor i Republikës së Kosovës. Parashtruesja e ankesës pretendon se pasi që nuk ka qenë në listë vëllau i saj, ai ka votuar me kusht në vendvotimin 1003D/01D por në rezultatin përfundimtar nga KQZ-ja nuk i ka dalur asnjë votë me kusht. Po ashtu parashtruesja e apelit pretendon se i mungon edhe vota e xhaxhait të saj i cili ka votuar me kusht në burgun e Smrenkovicës në Vushtri dhe vota një votueses e cila është deklaruar se e ka votuar me kusht në shtëpi nga Handikos në Busavatë, Komuna e Kamenicës. Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i që të verifikohen votat e saj me të cilën i mungojnë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të mbështetur pretendimet e saj të cekuar në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.841/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesues i Panelit
Zyheri Haxhiu


Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*